KËSHILLI I NDERIT pranë Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, SHGM, i përbërë nga: Sashe Dimovski, kryetar i Këshillit, dhe anëtarët: Mira Kostiq, Emilia Misirlievski, Ognen Janeski dhe Aleksandar Samarxhiev, anëtarë të Këshillit, duke vepruar sipas peticionit të Bogdani Ilievskit, kundër kumtesës së SHGM/SPGPM-së, në të cilën e përmendin publikisht për nxitje të dhunës verbale dhe gjuhës së urrejtjes, në seancën e mbajtur më 19.06.2024, solli këtë:

VENDIM

PARASHTRESA - REAGIMI I BOGDAN ILIEVSKIT KUNDËR KUMTESËS SË SHGM/SPGPM-së SEPSE KËSHILLI NUK KA KOMPETENCË NË KËTË LLOJ MOSMARRËVESHJE, POR NË TË NJËJTËN KOHË KUJTP SE ÇDO PËRDORUES I RRJETEVE SOCIALE ËSHTË PËRGJEGJËS PËR MODERIMIN E KOMENTEVE NËN NJË PUBLIKIM TË CAKTUAR, PËR ÇKA EKZISTON DHE PRAKTIKA GJYQËSORE

A R S Y E T I M

Bogdan Ilievski, drejtues i emisionit në TV Alfa, ka dorëzuar një reagim-parashtresë në KËSHILLIN E NDERIT NË SHGM, në lidhje me përmbajtjen e kumtesës së shpallur publikisht të SHGM-së dhe SPGPM-së, në të cilën bëjnë thirrje për veprim institucional pasi i njëjti ka shkruar koment dhe ka shpërndarë një pjesë të një interviste të një gazetareje nga një televizion tjetër, gjë që shkaktoi një ortek reagimesh negative, komentesh kërcënuese dhe gjuhë urrejtjeje ndaj saj dhe palëve të treta, që është vepër penale e parashikuar në Kodin Penal të Maqedonisë.

Bogdan Ilievski në reagimin e tij për Këshillin e Nderit thotë se:

"Unë nuk mbaj përgjegjësi për komentet që e pasuan, ashtu siç nuk mban përgjegjësi YouTube që e kam gjetur videon aty, dhe as pronari i TV 24 nuk mban përgjegjësi pse intervista është publikuar në televizionin e tij. Nuk është përgjegjëse as gazetarja Xhundeva, nuk ka për çfarë të përgjigjet, nëse preferenca e saj është të përdorë mbiemrin/përcaktuesin e Prespës në shfaqjet e një koncesionari të televizionit privat. Ajo ka çdo të drejtë në botë për ta bërë këtë, edhe pse nuk i kërkohet ligjërisht. Duke e njohur këtë të fundit, qasja e saj ndaj

temës ka vijuar me komentin: "Mirë, pse?".

Besoj se kam të drejtë të pyes përse, jo vetëm si gazetar që punon në televizion me koncesion kombëtar, por të njëjtën të drejtë do të kisha edhe sikur të isha një bari që punon në një livadh me një tufë delesh, sepse liria e mendimit dhe shprehja e pikëpamjeve është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë. Fakti që në tekstin e SHGM-së duket se është vetëm një gazetare (Xhundeva), dhe unë jam "udhëheqës i emisionit të mbrëmjes" dhe nuk kam as të drejtë mbrojtjeje, përkundrazi jam cilësuar si një nxitës i urrejtjes dhe kërcënimeve që do të çonin në dhunë, është një pyetje shtesë që meriton një përgjigje. Nëse jo këtu, do ta kërkoj para gjykatave"- deklaron Ilievski.

KËSHILLI I NDERIT e shqyrtoi reagimin dhe e hodhi poshtë atë për arsyet e mëposhtme:

- Këshilli i Nderit është kompetent të vendosë për aplikimin/shkeljen e Kodit të Gazetarëve në një tekst të caktuar gazetaresk, dhe nuk mund të ndërhyjë dhe rregullojë marrëdhëniet ndërmjet personave juridikë dhe fizikë që rezultojnë nga përmbajtjet e publikuara, pasi për këtë janë kompetentë organet shtetërore, të cilat do të vendosin në procedurë penale apo civile nëse ka elemente të veprës penale në nxitjen dhe mos moderimin e komenteve të autorit të rrjetit social apo përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje, siç paralajmëron Ilievski.

Mirëpo, Këshilli i Nderit i vë në dukje parashtruesit Bogdan Ilievski se ka një aktgjykim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kundër Francës nga viti 2021, në të cilin është vërtetuar qartë se çdo posedues i një rrjeti social, si dhe çdo media, është i obliguar dhe përgjegjës për moderimin e komenteve dhe përmbajtjeve nën një postim të publikuar, dhe përveç përgjegjësisë personale të autorit të komentit (për të cilin ka aktgjykime në gjykatat maqedonase për përhapjen e gjuhës së urrejtjes), edhe personi që e ka lejuar atë mund të bëhet përgjegjës.

Këshilli i Nderit përcaktoi se postimi i Ilievskit mund të vihej edhe në shkelje të Kodit të Gazetarëve, i cili ndalon konfrontimin me kolegët.

Personat publikë, kur kanë paraqitje publike, pavarësisht nëse bëhet fjalë për media tradicionale apo rrjete sociale, nuk kanë të njëjtin trajtim si dikush që ka një profil privat të dedikuar për një rreth më të ngushtë qytetarësh, prandaj duhet të jenë të vetëdijshëm për fjalët e shprehura publikisht, dhe pasojat që mund të lindin pavarësisht nëse ishte e qëllimshme ose jo.

Prandaj, KËSHILLI I NDERIT vendosi të refuzojë PARASHTRESËN e Ilievskit për shkak të mos-kompetencës, por duke u nisur nga mundësia e Rregullores për të reaguar publikisht ndaj ngjarjeve sipas vlerësimit të tij, tregon se të gjitha mediat, tradicionale, portalet, madje edhe rrjetet sociale, duhet të jenë të kujdesshme dhe të modelojnë komentet, duke hequr ato që bëjnë thirrje për dhunë, gjuhë të urrejtjes, intolerancë fetare, racore dhe lloje të tjera të mos-tolerancës.

Në botë ka shembuj ku kjo sferë është e rregulluar ligjërisht, gjë që nuk është rasti në Maqedoni, por duhet t'i kushtohet vëmendje normave të caktuara, të cilat po pranohen gjerësisht në botë.

Këshilli i Nderit në SHGM e mbështet plotësisht lirinë e fjalës dhe do të avokojë që ajo të mos kufizohet tek askush, por duhet pasur parasysh se liria nuk është e pakufizuar dhe ajo mbart edhe përgjegjësi.

Vendosur në Shkup, më 19.06.2024

-ti dorëzohet parashtruesit dhe të publikohet në ueb faqen e SHGM-së.

KËSHILLI I NDERIT NË SHGM

Sashe Dimovski, kryetar